



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0093

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE TONI O.P., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Çokut në Junik dhe Xhaminë e Orllanit në Podujevë” me numër të prokurimit 207-25-7067-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, më 27/03/2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e TONI O.P. me nr. 2026/0093, e datës 12/02/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Çokut në Junik dhe Xhaminë e Orllanit në Podujevë”, me numër të prokurimit 207-25-7067-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.
2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK për aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Çokut në Junik dhe Xhaminë e Orllanit në Podujevë”, me numër të prokurimit 207-25-7067-5-1-1.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 04.08.2025 MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Çokut në Junik dhe Xhaminë e Orllanit në Podujevë”

me numër të prokurimit 207-25-7067-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 542,389.30€.

Me 22.01.2026 MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE Eing Com.

Me 26.01.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 02.02.2026 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim

Me 12.02.2026, OE TONI O.P., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0093, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues TONI O.P., janë parashtruar si në vijim:

Në mbështetje të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ne operatori ekonomik “TONI O.P.”, në cilësinë e palës me interes juridiko-material, parashtrojmë këtë ankesë kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 22.01.2026 dhe Vendimit mbi Kërkesën për Rishqyrtim të datës 02.02.2026.

Si palë e pakënaqur me procesin e rivlerësimit të ofertave, paraqesim faktet dhe argumentet tona si në vijim.

Kronologjia e rrethanave të këtij aktiviteti të prokurimit

Kjo ankesë është e bazuar në Vendimin nr. 2025/0006, të datës 17.03.2025, të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Pretendimi kryesor në këtë ankesë lidhet me çështjen e gjykuar një herë në ankesën 2025/0006, në të cilën kemi qenë palë me interes dhe njëkohësisht palë ankuese.

Kërkojmë nga OSHP që, me vigjilencë dhe në mënyrë objektive e të pavarur, ta shqyrtojë këtë ankesë të kompanisë “TONI O.P.” dhe ta pranojë si të bazuar, duke kthyer lëndën në rivlerësim. Në të kundërtën, do të krijohej një standard i dyfishtë vendimmarrjeje dhe cenim i sigurisë juridike.

Me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 15.09.2025, ne si operator ekonomik jemi eliminuar nga procedura. Ky vendim është kundërshtuar nga ana jonë përmes

kërkesës për rishqyrtim, e cila është pranuar si e bazuar dhe me vendimin e datës 01.10.2025 ne jemi rekomanduar për kontratë.

Më pas, operatorët ekonomikë “EING COM” Sh.P.K. dhe “FRONI 1” Sh.P.K. kanë paraqitur ankesa në OSHP me numrat 1000/2025 dhe 1012/2025. Eksperti shqyrtues, në raportin e tij, ka devijuar nga pretendimet ankimore dhe ka interpretuar ligjin mbi marrëdhëniet dhe detyrimet si tërësi, pa u mbështetur në ndonjë bazë ligjore konkrete dhe pa u kërkuar nga palët. Në këtë mënyrë ai ka dalë jashtë kompetencave të tij ligjore (ultra vires) dhe ka rekomanduar kthimin e lëndës në rivlerësim.

Paneli Shqyrtues, në vendimin lidhur me ankesat 1000/2025 dhe 1012/2025, ka mbështetur raportin e ekspertit për kthimin e lëndës në rivlerësim, ndërsa pretendimet ankimore të operatorëve ankues i ka konstatuar si të paqëndrueshme.

Lidhur me Njoftimin mbi Vendimin e AK të datës 22.01.2026

Operatori i rekomanduar për kontratë “EING COM” Sh.P.K., bazuar në faktet dhe argumentet tona, është administrativisht i papërgjegjshëm dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, Ligjin e Punës si dhe Ligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Gjithashtu, kjo situatë është në kundërshtim me Vendimin nr. 2025/0006 të datës 17.03.2025 të OSHP-së.

Sa i përket operatorit “FRONI 1” Sh.P.K., konsiderojmë se edhe ky operator është administrativisht i papërgjegjshëm dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, si dhe në kundërshtim me Vendimin nr. 2025/0006 të OSHP-së.

Sa i përket eliminimit tonë, konsiderojmë se është bërë pa të drejtë. Arsytet e paraqitura në Letrën Standarde për Eliminim janë të pasakta dhe diskriminuese, si dhe përbëjnë një përsëritje të arsytimeve të vendimit të datës 15.09.2025, të cilat i kemi kundërshtuar përmes kërkesës për rishqyrtim dhe që vetë Autoriteti Kontraktues i kishte pranuar si të bazuara.

Kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar në mënyrë arbitrare, pa mbështetje ligjore dhe në kundërshtim me të drejtën tonë për konkurrencë të barabartë.

Pretendimi 1

Operatori i rekomanduar për kontratë “EING COM” Sh.P.K., në njoftimin e datës 22.01.2026, është shpallur fitues edhe pse në dy vendime paraprake të datave 15.09.2025 dhe 01.10.2025 ishte eliminuar.

Ky operator është i papërgjegjshëm, pasi nuk i plotëson kriteret e Dosjes së Tenderit dhe është në kundërshtim me Vendimin nr. 2025/0006 të OSHP-së.

Konkretisht, operatori është në kundërshtim me:

Kriterin nr. 2

Kriterin nr. 3, pika 3.1

Kjo për shkak se nuk ka angazhuar arkitektë sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Në kriterin nr. 2 është kërkuar që Menaxheri i Kontratës të jetë Master ose Inxhinier i Arkitekturës ose i Ndërtimtarisë – konstruktiv, ndërsa në kriterin 3.1 është kërkuar një Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master) si pjesë e listës së stafit profesional.

Nga lista e stafit të paraqitur rezulton se operatori ka angazhuar vetëm një arkitekte, znj. Ilirjana Azizi Mejzini, të cilën e ka emëruar si Menaxhere të Kontratës, ndërsa arkitekti Zgjim Lepaja është vetëm Bachelor i Arkitekturës, prandaj nuk i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit për nivel Master dhe përvojë profesionale pas diplomimit.

Rrjedhimisht operatori nuk e plotëson kriterin 3.1, pasi mungon një nga dy arkitektët e kërkuar me nivel Master.

Pretendimi 2

Në shqyrtimin e ankesave 1000/25 dhe 1012/25, konsiderojmë se Eksperti Shqyrtues nuk e ka përpiluar raportin duke u bazuar në faktet dhe pretendimet reale, por ka interpretuar Ligjin për Marrëdhëniet dhe Detyrimet, edhe pse asnjëra nga palët nuk e ka kërkuar një interpretim të tillë.

Me këtë veprim ai ka dalë jashtë kompetencave ligjore (ultra vires).

Kërkojmë që gjatë shqyrtimit të kësaj ankese raporti i ekspertit të përgatitet në mënyrë objektive dhe të paanshme, duke u bazuar në Vendimin nr. 0006/2025 të OSHP-së.

Pretendimi 3 – Konflikti i interesit

Menaxherja e Kontratës znj. Ilirjana Azizi Mejzini, e angazhuar nga operatori “EING COM” Sh.P.K., ndodhet në konflikt interesi me Autoritetin Kontraktues – MKRS.

Sipas CV-së së saj, ajo ka qenë e punësuar si Arkitekte në Divizionin e Menaxhimit të Integruar dhe Turizmit Kulturor në MKRS, gjatë periudhës nëntor 2022 – dhjetor 2023.

Në përputhje me nenin 18 paragrafi 1.3 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, një ish-zyrtar publik nuk mund të përfaqësojë ose ndihmojë një operator ekonomik në marrëdhënie biznesi me institucionin për një periudhë deri në dy (2) vite pas përfundimit të funksionit publik.

Meqenëse njoftimi për kontratë është publikuar më 04.08.2025, angazhimi i saj nga operatori ekonomik përbën konflikt interesi.

Pretendimi 4 – Mospërmbushja e kriterit për stafin

Operatori i rekomanduar nuk e plotëson Kriterin nr. 4, sipas të cilit duhet të paraqiten së paku 20 punëtorë profesional dhe mbështetës.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se lista e stafit, kontratat dhe CV-të janë në kundërtënie me njëra-tjetrën, duke krijuar pasaktësi për pozitat reale të stafit.

Disa nga këto kundërtënie janë:

Fexhri Podvorica – në listë suvatus, në kontratë punëtor

Venhard Oruqi – në listë llamarinë-punues, në kontratë shofer

Visar Bajgora – në listë punëtor fizik, në kontratë mjeshtër i përgjithshëm

Fisnik Bislimi – në listë punëtor fizik, në CV mjeshtër fasader/moler

Muhamet Lahi – në listë punëtor fizik, në kontratë mjeshtër moler

Hyzri Mehmeti – në listë punëtor fizik, në CV saldues, në kontratë mjeshtër i përgjithshëm

Afrim Pervetica – në listë punëtor fizik, në kontratë elektrikist

Këto kontradikta tregojnë se operatori nuk ka staf të qartë dhe të përcaktuar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, prandaj është administrativisht i papërgjegjshëm.

Pretendimi 5 – Kontrata të punës në kundërshtim me Ligjin e Punës

Operatori “EING COM” Sh.P.K.” ka paraqitur kontrata pune në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit për Punën, që rregullon pagën minimale.

Shembuj:

Visar Bajgora – pagë mujore 250 €, kontratë me orar të plotë

Fisnik Bislimi – pagë mujore 300 €, kontratë me orar të plotë

Këto kontrata janë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe ekziston dyshimi i bazuar se mund të jenë kontrata fiktive.

Pretendimi 6

Operatori “FRONI 1” Sh.P.K.” nuk e plotëson kriterin për stafin profesional, pasi i mungon një Inxhinier i Ndërtimtarisë – konstruktiv, sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Pretendimi 7 – Eliminimi i padrejtë i OE “TONI O.P.”

Arsyet e eliminimit tonë janë të njëjta me ato të vendimit të datës 15.09.2025, të cilat më herët janë pranuar si të pabazuara nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Kontratat që janë përmendur si aktive në vendim tashmë kanë përfunduar, si p.sh.:

Konservimi i Kullës së Ymer Pogës – përfunduar më 30.09.2025

Intervenime emergjente në objektet e trashëgimisë kulturore në Prizren – përfunduar më 05.06.2025

Restaurimi i Kullës së Astrit Kryeziut – punimet kanë përfunduar dhe është dorëzuar kërkesa për pranim teknik

Prandaj, sipas kriterit nr. 7, personi në fjalë nuk është i angazhuar në kontrata aktive.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Pas shqyrtimit të pretendimeve tuaja, Autoriteti Kontraktues jep këto përgjigje:

Përgjigje në pretendimin e parë:

Secili vlerësim i tenderëve është i pavarur dhe kryhet në mënyrë të paanshme, duke respektuar parimet themelore të prokurimit publik. Në këtë rast, procesi i vlerësimit është trajtuar në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i plotëson kriteret nr. 2 dhe nr. 3, siç janë të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk është në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili garanton barazinë në trajtim dhe ndalon diskriminimin.

Përgjigje në pretendimin e dytë:

Menaxherja e kontratës, znj. Ilirjana Mejzini, e emëruar nga OE fitues “EING SH.P.K.”, nuk përbën konflikt interesi. Ky konstatim bazohet në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton qartë rastet kur mund të konsiderohet se ekziston konflikt interesi. Në këtë rast, angazhimi i saj nuk bie ndesh me dispozitat ligjore dhe nuk ndikon në paanshmërinë e procesit të vlerësimit apo të zbatimit të kontratës.

Përgjigje në pretendimin e tretë:

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë e plotëson kriterin nr. 4 duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, i cili dëshmon pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Vlerësimi i bërë nga Komisioni i Vlerësimit ka konfirmuar se ky kriter është përmbushur në mënyrë të plotë.

Përgjigje në pretendimin e katërt:

Sa i përket kontratave të paraqitura nga “EING SH.P.K.”, Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë të kontrollojë vlerat e kontratave apo shumën e pagave të stafit të angazhuar. Vlerësimi bëhet vetëm mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, duke u fokusuar në përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale dhe jo në aspektet financiare të brendshme të operatorit ekonomik.

Përgjigje në pretendimin e pestë:

Të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë respektuar dhe verifikuar gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë dhe ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 13.02.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0093, ndërsa me datë 26.02.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0093, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur reth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE TONI O.P., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0093 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1

OE ankues pretenon se aryeja e eliminimitiqë sipas AK_së :

“Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye : në kërkesën e Dosjes së tenderit - Kriteri numër 7. O.E. duhet të siguroj nuk ka me shume se tri kontrata aktive me MKRS-ne të natyrës së njëjtë, respektivisht në planin dinamik të punës nuk mund të jetë i njëjti arkitekt i licencuar ose mjeshtër i licencuar i angazhuar në më shumë se tri kontrata tjera të natyrës së njëjtë. Dhe 7. Nëse O.E. konkuron në disa projekte restauruese në planin dinamik të punës nuk mund të figurojë i njëjti arkitekt i licencuar, ose mjeshtër i licencuar në më tepër se tri kontrata i angazhuar në të njëjtën kohë (njëjtat data kalendarike). Ju nuk e plotësoni këtë kriter për arsye se keni të angazhuar Mjeshtër me Licencë A2-3 në më tepër se tre kontrata. Mjeshtër me Licencë A2-3(z. Sh.B.) është i angazhuar në këto kontrata: 1. Konservimi Restaurimi i Kullës së Ymer Pogës - Rugovë e Hasit, Intervenime emergjente në objektet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit, 3. Restaurimi dhe Konservimi i Kullës së Astrit Kryeziut (Tosun Beut), 4. Ndërhyrje konservuese dhe restauruese në Shtëpinë e Ymer Elshanit në Drenas 5. Restaurimi dhe Konservimi - Kulla e Astrit Kryeziut - Tosun Beut në Gjakovë.”.

ANë refuzim të kërkesës për rishqyrtim AK potencon se:

“ Pas shqyrtimit të pretendimit tuaj, Përgjigje në pretendimin e parë: Secili vlerësim i tenderëve është i pavarur dhe kryhet në mënyrë të paanshme, duke respektuar parimet themelore të prokurimit. Në këtë rast, procesi i cili nënë vlerësimit është trajtuar në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës. OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kriteret nr. 2 dhe nr. 3, siç janë të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor nuk është në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), ? i garanton barazinë në trajtim dhe ndalon diskriminimin. Përgjigje në pretendimin e dytë: Menaxherja e kontratës, znj. Ilirjana Mejzini, e emëruar nga OE fitues “EING SH.P.K.”, nuk përbën konflikt interesi. Ky konstatim bazohet në Ligjin për Konfliktin e Interesit, i cili përcakton qartë rastet kur mund të konsiderohet se ekziston konflikt. Në këtë rast, angazhimi i saj nuk bie ndesh me dispozitat ligjore dhe nuk ndikon paanshmërinë e procesit të vlerësimit apo zbatimit të kontratës. Përgjigje në pretendimin e tretë: Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i plotëson kriterin nr. 4, duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm duke dëshmuar pajtueshmëri me kërkesat e

përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Vlerësimi i bërë nga Komisioni ka konfirmuar se ky kriter është përmbushur në mënyrë të plotë. Përgjigje në pretendimin e katërt: Sa i përket kontratave të paraqitura nga "EING SH.P.K.", Autoriteti Kontraktor nuk ka kompetencë të kontrollojë vlerat e kontratave apo shumën e pagave të stafit të angazhuar. Vlerësimi bëhet vetëm mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, duke u fokusuar në përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale, jo në aspektet financiare të brendshme të operatorit ekonomik. Përgjigje në pretendimin e pestë: Të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë respektuar dhe verifikuar gjatë procesit të rishqyrtimit. Bazuar në më sipër, pretendimet juaj konsiderohen të pabazuara dhe refuzohen në tërësi.”

Eksperti shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, ne veçanti kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës në OSHP, jep mendim se kontratat për të cilat OE ankues pretendon se janë të përfunduara, nuk mund të merren për bazë për eliminim të OE ankues pasi kërkesa e dosjes e kufizon që stafi të mos jetë i përfshirë në tri (3) kontrata “aktive”.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar edhe pse për një kontratë nuk ka pranim teknik, nëse kontratat tjera e theksuara nga OE vërtet janë të përfunduara/mbyllura prap OE ankues është në pajtim me kërkesat/kufizimet e dosjes së tenderit.

Pretendimi nr.2

Sa i përket pretendimeve ankimore kundrejt OE tani të rekomanduar për kontratë lidhur me arkitektin/arkitektët, eksperti shqyrtues sqaron se kjo qështje është trajtuar [përmes vendimeve të OSHP-së me nr.1000/25 dhe 1012/25, rrjedhimisht vlerësojmë se kjo është qështje e gjykuar dhe se pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankueses ku thirret në vendimin 06/2025 të OSHP-se, sqarojmë se ai vendim sa pari ka të bëjë me aktivitet tjetër të prokurimit, e po ashtu (sipas mendimit të ekspertit) nuk është situatë apo rrethana identike me rastin konkret.

Për këto aktivitet të prokurimit dhe këtë qështje konkrete janë vendimet e OSHP-se nr.1000/25 dhe 1012/25.

Pretendimi n.3

Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me stafin/punëtorët, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesat e dosjes së tenderit kanë qenë :

“4.6. Së paku 10 punëtorë në punë të ndryshme, si p.sh. shtrues pllakash, suvatues, instalues, mjeshtër kulmi, llamarinë punues, saldues, etj.”

Ndërsa dëshmia dokumentare lidhur me këtë kërkesë ka qenë :

“Për stafin numër 4.6 duhet të kenë se paku 3 vite përvojë pune (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga punëtori) dhe Kontrata e punës ose parakontrata (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE).”

Në rastin konkret, për dhjet punëtorët “në punë të ndryshme”, (për dallim nga pozitat tjera profesionale) nuk është kërkuar asnjë lloj dëshmie lidhur me kualifikimet/aftësitë e këtyre punëtorëve si psh, certifikatë, diplomë, apo çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon kualifikimet e stafit në punë të ndryshme, rrjedhimisht eksperti shqyrtues jep mendim se kjo nuk mund të

përdoret si arsye për eliminim të OE dhe pretendimi ankimor është i pabazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Xhaminë e Çokut në Junik dhe Xhaminë e Orllanit në Podujevë” me numër të prokurimit 207-25-7067-5-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - TONI O.P.**
- Arkivës së OSHP-së: